URDHËR
Nr. 667, datë 4.10.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të nenit 5, të ligjit nr. 8038, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për nënshkrimin e:
   - Licencave dhe të certifikatave të operimit, për transportin ndërqytetës të udhëtarëve;
   - Certifikata për transport ndërkombëtar dhe të brendshëm të rastit.
2. Delegimin e kompetencës DPSHTRR-së për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve për miratimin e licencave nëpërmjet QKB-së, në veprimtarinë e nën-kategorisë VII.7.1, "Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve".
3. Në ushtrimin e kësaj kompetence, DPSHTRR-ja të zbatojë kriteret e përcaktuara, në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar; në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar.
4. Ngarkohet DPSHTRR-ja për zbatimin e këtij urdhri dhe koordinimin me QKB-në për zbatimin e procesit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri